

LIGJ
Nr. 83/2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 87/2019, “PËR FATURËN DHE SISTEMIN
E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën “b”, të nenit 4, fjalët “në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore” zëvendësohen me fjalët “në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat”.

Neni 2

Fjalja e dytë, e pikës 2, të nenit 9, ndryshohet si më poshtë:

“Nëse blerësi është individ i peregjistruar si subjekt për ushtrim aktiviteti tregtar, në faturë shënohet emri i tij i plotë, numri personal i identifikimit ID dhe adresa e saktë ku dërgohen mallrat.”.

Neni 3

Në pikën 2, të nenit 17, fjalët “ditën e dhjetë” zëvendësohen me fjalët “ditën e njëmbëdhjetë”.

Neni 4

Në fjalinë e parë, të pikës 10, të nenit 20, fjalët “tri ditë” zëvendësohen me fjalët “shtatë ditë”.

Neni 5

Kudo në përmbajtjen e ligjit fjalët “tatimit mbi fitimin” zëvendësohen me fjalët “tatimit mbi të ardhurat e korporatës” dhe fjalët “tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” zëvendësohen me fjalët “tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 20, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**